

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e 32-të e Këshillit të Agjencisë për**  
**Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,**  
**të mbajtur më datë 17.08.2022**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes konferenciare:**  
Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /**

**Në mbledhje, përmes lidhjes konferenciare ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm përmes lidhjes konferenciare, nga Shërbimi profesional ishin:** m-r Dragica Ljubevska, m-r Magdalena Davidovska Dovleva, Vesna Simonovska, m-r Arben Saiti, Maja Damevska, m-r Ruzhica Boshnakoska Jotevska, d-r Ivana Stojanovska.

**Të pranishëm të tjerë: /**

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 32-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 16:05 dhe u realizua përmes lidhjes video konferenciare.

Z. Petrushevski sqaroi se radiodifuzeri e pagoi kompensimin vjetor për lejen dhe për këtë do të bëhet ndryshim në titullin e Pikës 2 si vijon – Propozim-Aktvendim për ndërprerjen e procedurës për heqjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit, televizioni IRIS SHPK Shtip.

Këshilli i Agjencisë me korrigjimet e propozuara, njëzëri miratoi si vijon:

**R E N D I T E**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 31-të e këshillit të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më datë 12.08.2022
2. Propozim-Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit, televizioni IRIS SHPK Shtip.
3. Të ndryshme

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin nga mbledhja e 31 e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më date 12.08.2022, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z. Trajçevski e arsyetoi Aktvendimin e propozuar për ndërprerje të procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit IRIS SHPK Shtip. Sqaroi se sot radiodifuzeri e ka paguar shumën e kompensimit vjetor për lejen e emetimit televiziv dhe me këtë janë shmangur arsyet për heqjen e lejes. Në këtë drejtim propozohet që Këshilli ta ndërpresë procedurën e iniciuar ndaj TV Iris.

Z. Petrushevski tha se pagesa është bërë në moment të fundit dhe shërbimi ka dorëzuar deri te anëtarët e Këshillit, materiale për njoftim deri te Drejtori dhe Sektori i Financave dhe Logjistikës, se pagesa është bërë në shumë prej 103.321,00 denarë, si dhe me propozim deri te Këshilli për të ndërprerë procedurën ndaj TV Iris. Me këtë tha se janë shmangur të gjitha arsyet për heqjen e lejes dhe hapi diskutim.

Z. Fidanoski tha se është shumë mirë që radiodifuzeri e ka larguar arsyen për heqjen e lejes në moment të fundit. Mirëpo si qëndrim personal theksoi se edhe pse parimisht gjithmonë duhet të tolerohen radiodifuzerët edhe gjithmonë do të jetë në atë qëndrim, ky radiodifuzer jep një arsye dhe shkas të mirë që ky debat publik ku flitet edhe për shkurtimin e afateve, të zhvillohet në tërësi.

Z. Trajçevski qartësoi se afatet e kësaj procedure, respektivisht të inicimit dhe heqjes së lejes për emetim të radios dhe televizionit, nuk mund të ndryshohen sepse janë të përcaktuara edhe me Ligj. Ato në njëfarë mënyre janë të lidhura por nuk mund të jenë lëndë e Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë, për marrjen e masave për çka momentalisht Agjencia ka hapur debat publik.

Z. Petrushevski tha se diskutimin e z. Fidanoskit e ka kuptuar si propozim për të korrigjuar Ligjin.

Z. Fidanoski sqaroi se drejtori Trajçevski ka të drejtë por kuptimi i diskutimit ka qenë në atë drejtim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerje të procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit IRIS SHPK Shtip, Up1 nr.08-902 nga data 08.07.2015.

SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip, më datë 17.08.2022 ka bërë pagesën e shumës prej 103.321,00 (njëqind e tremijë e dyqind e një ) denarë , me çka radiodifuzeri e ka paguar në tërësi kompensimin vjetor të lejes për emetim televiziv.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe të Këshillit, e ka publikuar aktvendimin e lartpërmendur në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit shpreson se ndoshta do të përmirësohen parametrat ekonomik në Maqedoni dhe më gjerë në Evropë dhe botë, dhe se ky radiodifuzer do të jetë shumë më i rregullt gjatë pagesave.

**Pika 3**

**Të ndryshme**

Për këtë pikë nuk kishte diskutim.

**Nr. 02-3155/2  
25.08.2022**

**Shkup**

**Agjencia për shërbime Mediatike  
audio dhe Audiovizuele  
Kryetar i Këshillit,  
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**